

**Planprogrami për lëndën:
E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme
2017-2018**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme
Niveli:	Themelor
Statusi lëndës:	E detyrueshme
Viti i studimeve:	Viti IV
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	8 ECTS
Koha / lokacioni:	E hënë, 11.30-14.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc.Rexhep Murati, profesor i rregullt
Detajet kontaktuese:	Email: rexhepmurati@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme ofron njohuri themelore për rrjedhën e procedurës penale, përkatësisht themelimi, zhvillimin dhe përfundimin e raportit penalo procedural. E drejta e procedurës penale ka për objekt rrjedhën e procedurës penale e cila ndahet në stadi, fazë dhe etapa përkatëse. Përveç, kësaj E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme, tregon për dallimet që ekzistojnë ndërmjet formave të ndryshme të procedurës penale (procedurës së rregullt, procedurës për të mitur dhe procedurave të alternative etj.). Objekt i studimit të procedurës penale-pjesa e posaçme janë edhe disa procedura me karakter jo penal të cilat janë kusht për zhvillimin e procedurës penale ose janë pasojë e zhvillimit të procedurës penale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme. Njohuritë e fituara nga E drejta e procedurës penale e përgjithshme bashkë me njohuritë nga E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme mundësojnë që procedura penale në tërësi të kuptohet drejtë dhe në mënyrë të plotë.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij programi studentet duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të fitojnë njohuri të thelluara për rrjedhën e procedurës penale nga fillimi e deri në përfundimin e saj.

	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve procedural si edhe të bëjnë dallimin ndërmjet veprimeve të subjekteve procedural gjatë rrjedhës së procedurës penale ; - të njihet me llojet e provave të cilat vinë në shprehje në procedurën penale, e në veçanti me domosdonë e përjashtimit të provave të pa pranueshme, në të cilat nuk mund të mbështet vendimi gjyqësor; - të mësohen të analizojë me kujdes çështjet juridike dhe çështjet faktike; - të fitojë aftësi analitike të domosdoshme dhe të kultivojnë qasje kritike ndaj zgjidhjeve procedurale aktuale - duke fituar njohuri themelore nga E drejta e procedurës penale-pjesa e posaçme, ata do jenë në gjendje që këto njohuri t'i zgjerojnë dhe thellojnë në procesin e mëtejshëm të përsosjes së tyre profesionale. - pas përfundimit me sukses të këtij kursi dhe kursit vijues në programin master-në drejtimin penal, që për objekt të studimit ka aspekte të ndryshme nga E drejta e procedurës penale pjesa-e posaçme, studenti sa i përket kësaj fushe do të jetë në gjendje që në të ardhmen në praktikë të interpretoj drejtë dhe të zbatojë me sukses dispozitat e legjislacionit penal.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min.	15	5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfieme,seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5

Projektet,prezentimet ,etj	1	20	20
Totali			200
Metodologjia e mësimëdhënies:			
	<p>Mësimi në klasë do të realizohet përmes ligjëratave interaktive në të cilat do të shpjegohen dhe analizohen rrjedha e procedurës penale nga fillimi deri në përfundimin e saj. Duke qenë se ligjëratat do të kenë karakter interaktiv, studentët do të motivohen që të shtrojnë pyetje, të bëjnë komente si edhe të ngrisin çështje për diskutim lidhur me temën e cila trajtohet. Për të realizuar mësimin sipas kësaj metode të mësimit , nga studentet do të kërkohet që paraprakisht të lexojnë literaturën e detyruar dhe literaturën shtesë të përcaktuar në planprogram.</p>		
Metodat e vlerësimit:			
	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes pranisë së studentëve, seminareve, prezantimeve, kolokviumeve e të tjerë dhe provimit me shkrim.</p> <p>Me fjalë të tjera, vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes metodave si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vijimi i rregullt në ligjërata dhe seminare dhe pjesëmarrja aktive...10% ; - prezantimet individualisht ose në grup dhe punimet seminarike.....20%; - kolokviumi i parë 35%; - Kolokviumi i dytë 35%; - Totali: 100% 		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, Murati, Rexhep, Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006. Bayer, Vladimir, Kazneno procesno pravo-odabrana poglavlja. Knjiga II, Povijesni razvoj kaznenog procesnog prava, përgatiti: Davor Krapac, Zagreb, 1995.</p>		

	<p>Pavišić, Berislav, Komentar Zakona o kaznenom postupku, Šmrka, 2015.</p> <p>Pavišić, Berislav (ed.), Transition of Criminal Procedure Systems, Rijekë, 2004.</p> <p>Pavišić, Berislav, Karakteristikat themelore të trazicionit të procedurave penale, E drejta, Prishtinë, 2004., nr. 4.</p> <p>Sijerčić-Čolić Hajrija, Krivično procesno pravo, knjiga II, Tok redovnog krivičnog postupka i posebni postupci, Sarajevo, 2005.</p> <p>Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentar i Kodit të procedurës penale, Prishtinë, 2014.</p> <p>Murati, Rexhep, Protection of Human Rights Under Kosovo's Criminal Code and Criminal Procedure Code, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Number 1, 2005.</p> <p>Sahiti, Ejup, Dëshmia e dëshmitarit si prove në procedurën penale, Prishtinë, 1993.</p> <p>Sahiti, Ejup, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë, 2006.</p> <p>Sahiti Ejup, Murati Rexhep, Kunštek Eduard, "Criminal Procedure System of Kosovo", ed. Berislav Pavišić, "Transition of Criminal Procedure Systems", Rijeka, 2004., fq. 125-145</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Bayer, Vladimir, Kazнено procesno pravo-odabrana poglavlja. Knjiga I. Uvod u teoriju krivičnog procesnog prava, përgaditi, Davor Krapac Zagreb, 1995.</p> <p>Bavcon, Ljubo, Šelih A et al.: Međunarodno kazensko pravo. Ljubljana, 1997.</p> <p>Cook, Joseph G., Marcus, Paul, Criminal Procedure, Third Edition, New York, Oakland (CA), 1992.</p> <p>Damaška, Mirjan, Okrivljenikov iskaz kao dokaz u suvremenom krivičnom procesu, Zagreb, 1962.</p> <p>Damaška, Mirjan, O miješanju inkvizitornih i akuzatornih procesnih formi, Hrvatski ljetopis za kazнено pravo i praksu (HLJKPP), Zagreb, 1997., vol. 4, nr. 2 fq. 381-394.</p> <p>Damaška, Mirjan, Izazovi slobodnoj ocjeni dokaza. HLJKPP, Zagreb, 1995, vol. 2 nr.1, fq. 41-55</p> <p>Delmas-Marty, Mireille (ed.), Procedure penali d'Europa, Padovë, 2001</p> <p>Dressler, Joshua, Understanding Criminal</p>

	<p>Procedure, New York (USA) and Oakland (CA), 1991.</p> <p>Gates, John, Johnson, Charles, Gjykatat amerikane: Analizë kritike, Tiranë, 1997.</p> <p>Grubač, Momčilo, Krivično procesno pravo, botim i katërtë i ndryshuar dhe i plotësuar, Beograd, 2006.</p> <p>Grubiša, Mladen, Činjeno stanje u krivičnom postupku, botimi i dytë, Zagreb, 1980.</p> <p>Jekić, Zagorka, Krivično procesno pravo, botimi i shtatë, Beograd, 2001.</p> <p>Kamisar, Yale, Lafave, Wayne R., Israel, Jerold H., King, Nancy, Modern Criminal Procedure: Cases, Comments, Questions, Ninth Edition, St. Paul, Minn, 1999.</p> <p>Krapac, Davor, Kazнено procesno pravo, libri i parë: institucije, botim i dytë i ndryshuar dhe i plotësuar, Zagreb, 2003.</p> <p>Krapac, Davor, Engleski kazneni postupak, Zagreb, 1995.</p> <p>Krapac, Davor, Europska konvencija o zaštiti ljudskih prava i temeljnih sloboda i hrvatski kazneni postupak, HLJKPP, Zagreb, 1995., vol. 2, nr. 1.</p> <p>Pavišić, Berislav, Komentar Zakona o kaznenom postupku, botimi i pestë, Rijeka, 2005.</p> <p>Pavišić, Berislav, Komentar Zakona o kaznenom postupku, Rijeka, 2013.</p> <p>Pavišić, Berislav, Bertaccini Davide (eds.), Le altre procedure penali: Transizioni dei sistemi processuali penali, Torino, 2002.</p> <p>Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013</p> <p>Sijerčić-Čolić, Hajrija, Vuleta, Draško, Hadžiomerađić, Malik, Komentar Zakona o krivičnom postupku, Sarajevo, 1999.</p> <p>Sijerčić-Čolić Hajrija, Krivično procesno pravo, knjiga I, Krivičnoproceni subjekti i krivičnoproceni radnje, Sarajevo, 2005.</p> <p>Sijerčić-Čolić Hajrija, Krivično procesno pravo, knjiga II, Tok redovnog krivičnog postupka i posebni postupci, Sarajevo, 2005.</p> <p>Sijerčić-Čolić Hajrija, Hadžiomerađić Malik, Jurčević Marinko, Kaurinović Damjan i Simović Miodrag, Komentari zakona o krivičnom /kaznenom postuku u Bosni i Hercegovini, Sarajevo, 2005.</p>
--	--

Tomašević, Goran, Kazнено procesno pravo: temeljni pojmovi i osnove praktične primjene, Split, 1998. godine.

Tomašević, Goran, Osnove atenskoga krivičnoga postupka klasičnog doba, Zbornik Pravnog Fakulteta, Split, XXVII, 1990.

Vasiljević Tihomir, Sistem krivičnog procesnog prava SFRJ, botim i tretë, Savremena administracija, Beograd, 1981.

Vasiljević, Tihomir, Sistem krivičnog procesnog prava SFRJ, botim i dytë, Beograd, 1971.

Zupančić, Boštjan et al., Ustavno kazensko procesno pravo, Ljubljana, 1996

Studentet duhet t'i studiojnë edhe dispozitat përkatëse me të cilat rregullohet procedura penale në Kosovë dhe konventat e OKB-së për të drejtat dhe liritë e njeriut, Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe dokumentet të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me sa vijon:

Kodi penal i Kosovës, Kodi nr. 04/L-082, G. Z. Nr. 19/ 2012, dhe Nr.30/2012.

Kodi i procedurës penale i Kosovës, Kodi nr. 04/L-123 ,G.Z., Nr. 37/ 2012.

Kodi i Drejtësisë për të mitur, Kodi nr. 03/L-193 ,G.Z. Nr.78/2010.

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Nr.03/L-191, G.Z. nr.79/2010.

Ligji për gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, G.Z. 79/2010 dhe Nr. 03/L-171, G.Z. nr. 28/2012.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Ligji nr. 03/L-121,G.Z. nr. 46/2009.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223, G.Z. 84/2010.

Ligji për prokurorin e shtetit, Ligji nr. 03/L-225, G.Z. 83/2010.

Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-052, G.Z. 27/2008.

Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224, G.Z. 83/2010.

Ligji për Avokatinë, Nr. 03/L-117.

	<p>Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 <i>Universal Declaration on Human Rights</i>, G.A.res. 217 A(III), U.N. Doc. A/810 at 71</p> <p>Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike me protokollet e vitit 1966 <i>International Covenant on Civil and Political Rights</i>, G.A. res. 2200A (XXI), 21 U.N. GAOR Supp. (No.16) at 52, U.N. Doc. A/6316 (1966), 999 U.N.T.S. 171, entered into force Mar. 23, 1976.</p> <p>Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor i vitit 1966 <i>International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights</i> G.A. res. 2200A (XXI), 21U. N. GAOR Supp (No.16) at 49, U.N. Doc. A/6316 (1966), 993 U.N.T.S. 3, entered into force Janeni 3, 1976.</p> <p>Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, me protokollet shtesë <i>European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms</i>, (ETS No. 5), 213 U.N.S. 222, entered into force Sept. 3,1953, as amended by Protocols No 3, 5, 8, i 11 which entered into force on 21 September 1970, 20 December 1971, 1 January 1990, and 1 November 1998 respectively.</p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>E DREJTA E PROCEDURËS E VEÇANTË RRJEDHA E PROCEDURËS PENALE</p> <p>Nocioni dhe objekti i të drejtës së procedurës penale të veçantë. Rrjedha e procedurës penale–stadet e procedurës penale. Procedura parapenale. Nocioni i procedurës parapenale. Autorizimet e policisë në procedurën parapenale. Kallëzimi penal. Vendimet e prokurorit të shtetit përkitazi me kallëzimin penal.</p> <p>Forma procedurale e veprimeve të kryera nga policia.</p>

<p>Java e dytë:</p>	<p>PROCEDURA PARAPRAKE</p> <p>HETIMET. Kuptimi i procedurës paraprake. Funkzioni, natyra juridike e procedurës paraprake dhe bartësit e saj. Hetimi, kuptimi dhe qëllimi i hetimeve. Fillimi, rrjedha dhe përfundimi i hetimeve. Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndës së hetimit, pezullimi dhe pushimi i hetimeve. Kohëzgjatja e hetimeve.</p> <p>PROCEDURAT ALTERNATIVE.</p> <p>AKUZIMI. Ngritja e akuzës dhe llojet e akteve paditëse. Aktakuza dhe përmbajtja e aktakuzës. Procedura për ngritjen e aktakuzës. Shkresat që e plotësojnë aktakuzën. Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës. Kontrollimi i akuzës përkatësisht i aktakuzës. Shqyrtimi fillestar. Shqyrtimi i dytë.</p>
<p>Java e tretë:</p>	<p>PROCEDURA PENALE KRYESORE .</p> <p>Përgatitja e shqyrtimit gjyqësor. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shqyrtimin gjyqësor. Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor. Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor. Parakushtet (supozimet) për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor. Shqyrtimi gjyqësor dhe rrjedha e tij. Hapja e seancës gjyqësore Fillimi shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit lidhur me akuzën. Procedura provuese (prezantimi i provave).</p>
<p>Java e katërt:</p>	<p>AKTGJYKIMI. Marrja, shpallja dhe përpilimi me shkrim i aktgjykimit. Llojet e aktgjykimit. Aktgjykimi refuzues, dënues (kondemnator) dhe lirues (liberator). Shpallja dhe përpilimi me shkrim i aktgjykimit.</p>
<p>Java e pestë:</p>	<p>MJETET JURIDIKE</p> <p>Në përgjithësi për mjetet juridike. Kuptimi, arsytimi dhe qëllimi i mjeteve juridike. Llojet e mjeteve juridike. Rregullat e përgjithshme të procedurës ankimore.</p> <p>MJETET JURIDIKE TË REGULLTA. Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës. Përmbajtja e ankesës. Bazat për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit. Shkeljet esenciale (qenësore) të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike dhe atakimi i aktgjykimit të shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal.</p>

Java e gjashtë:	<p>PROCEDURA LIDHUR ME ANKESË KUNDËR AKTGJYKIMIT TË SHKALLËS SË PARË</p> <p>Procedura lidhur me ankesë në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e shkallës së dytë. Seanca e kolegjit të apelit. Shqyrtimi në Gjykatën e Apelit. Kufijtë e shqyrtimit të aktgjykimit të shkallës së parë të atakuar me ankesë. Vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me ankesë. Rigjykimi. <i>Beneficium cohaesionis dhe reformatio in peius</i></p> <p>ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË APELIT</p> <p>ANKESA NË AKVENDIM</p>
Java e shtatë:	<p>Java e shtatë</p> <p>MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE</p> <p>RISHIKIMI I PROCEDURËS PENALE. Vazhdimi i procedurës penale. Rishikimi jo i drejtë i procedurës penale. Rishikimi i drejtë i procedurës penale</p> <p>KËRKESA PËR ZBUTJEN E JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT</p> <p>KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË</p>
Java e tetë:	<p>PROCEDURA NDAJ TË MITURËVE</p> <p>Në përgjithësi për procedurën ndaj të mitarëve. Karakteristikat themelore të procedurës ndaj të miturve.</p>
Java e nëntë:	<p>RRJEDHA E PROCEDURËS PËR TË MITUR</p> <p>Procedura paraprake. Fillimi dhe zbatimi i procedurës përgatitore. Arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi i të miturit Akuzimi në procedurën ndaj të miturve. Procedura dhe kompetencat e trupit gjykues për të mitur dhe shqyrtimi gjyqësor. Mjetet juridike. Ekzekutimi i masave edukative institucionale. Pushimi i ekzekutimit dhe ndryshimi i vendimit mbi masat edukuese.</p>
Java e dhjetë:	<p>Java e dhjetë</p> <p>PROCEDURAT E VEÇANTA</p> <p>URDHRI NDËSHKIMOR- Nocioni u urdhrimit ndëshkimor. Procedura për dhënien urdhrimit ndëshkimor. Zhvillimi i</p>

	<p>shqyrtimit gjyqësore në bazë të kundërshtimit kundër urdhrit ndëshkimor.</p> <p>SHQIPTIMI I VËREJTJES GJYQËSORE. Nocioni i vërejtjes gjyqësore. Procedura lidhur me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PPROCEDURAT PËR ZBATIMIN E TYRE.</p> <p>Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore. Në përgjithësi për masat për trajtim të detyrueshëm psikiatrik.</p> <p>Procedura për të vlerësuar aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit. Procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në rast të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale. Procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në rast të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale.</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>PROCEDURA PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PËR REHABILITIM NDAJ PERSONAVE TË, CILËT KANË KRYER VEPËR PENALE NËN NDIKIMIN E ALKOHOLIT OSE E DROGËS.</p> <p>PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DËNIMEVE ALTERNATIVE</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>PROCEDURA PËR MARRJEN E VENDIMIT MBI SHLYERJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA</p>
Java e katërbëdhjetë:	<p>PROCEDURA PËR KOMPENSIM DËMI, REHABILITIM DHE PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË TJERA TË PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA BAZË</p> <p>Kuptimi i së drejtës në kompensim dëmi, rehabilitim etj si e drejtë themelore e njeriut. Kushtet që duhet të përmbushën për kompensim dëmi të personave të dënuar dhe të arrestuar pa bazë. Rehabilitimi i personave të dënuar apo të arrestuar pa bazë. Procedura për realizimin e të drejtave të tjera.</p>
Java e pesëmbëdhjetë:	<p>PROCEDURA PËR DHËNIEN E LETËRRESHTIMIT DHE SHPALLJES PUBLIKE</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Gjatë mbajtjes së mësimit, kolokviumeve dhe provimeve studentet duhet të sillen në përputhje me standardet e mirësjelljes akademiken dhe në pajtim Statutin e Universitetit të Prishtinës , rregulloret përkatëse të Fakultetit dhe Kodin etik të studentëve.

Shkurt, 2018
Prishtinë

Dr. sc. Rexhep Murati, profesor i rregullt